

Tiranë 22 Prill 2026

DRAFT

DEKLARATE PËR MEDIA

“Mbi krizën karburanteve, të rritjes së çmimeve dhe pasojave në zhvillimin ekonomik në hapsirën mbarëshqiptare “

Forumin Ekonomik Mbarëshqiptar/**FEMSH** në bashkëpunim me Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, DHTIT dhe shoqatat e biznesit si: Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar/**KASH**, Shoqata e industrisë Ushqimore Shqiptare;/ **SHIUSH** Aleanca Kosovare e Bizneseve/**AKB**, PRO-Eksport Albania, Shoqata e Ndërtuesve, Shoqata Shqiptare e Turizmit, Shoqata e Transportit Publik, Shoqata e Industrisë së Përpunimit të Qumështit (IPQ), Shoqata e Bimëve Medicinale, Shoqata e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare; që i bashkohen kësaj deklarate,

-Shprehin shqetësimin e përbashkët mbi thellimin e krizës së vazhdueshme të rritjes së çmimeve të karburanteve në tregjet globale. Përshkallëzimi i tensioneve në Lindjen e Mesme po thellon më tej krizën energjetike, duke ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi ekonominë në hapsirën mbarëshqiptare.

Në koordinim të ngushtë me komunitetin e biznesit në nivel rajonal, përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Luginën e Preshevës, vlerësojmë se kriza e derivateve të naftës përbën një sfidë të përbashkët strukturore për ekonominë e rajonit, e cila kërkon qasje të harmonizuara dhe ndërinstitucionale.

Karburanti nuk është thjesht një produkt por është një input strategjik që shërben për çdo sektor të ekonomisë. Rritja e çmimit të tij po gjeneron një efekt zinxhir, i cili po reflektohet në:

- rritjen e kostove të prodhimit dhe shërbimeve;
- rritjen e çmimeve për konsumatorin;
- uljen e fuqisë blerëse dhe
- dobësimin e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në rajon dhe më gjerë.

Rritja e kostove dhe pasiguria e vazhdueshme në tregjet energjetike po ndikojnë gjithashtu në klimën e investimeve. Bizneset po shtojnë planet për zgjerim dhe investimet e reja po ngadalësohen, ndërsa rritet rreziku i zhvendosjes së kapitalit drejt tregjeve më të qëndrueshme. Kjo situatë rrezikon të dobësojë potencialin afatgjatë zhvillimor të ekonomisë dhe aftësinë për të tërhequr investime produktive në hapsirën mbarëshqiptare.

Për vendet e rajonit, nga qeveritë respektive ku operon sipërmarrja mbarëshqiptare, perballë kësaj krize globale, i bën të domosdoshme ndërhyrjet fiskale dhe mekanizmat e përkohshëm të stabilizimit të tregut , siç është çmimi tavan. Keto masa nuk duhet të shihen si masa që dëmtojnë buxhetin e shtetit, por si instrumente të menaxhimit dhe mbrojtjes së stabilitetit ekonomik dhe social, në përballimin e kësaj sfide për të gjithë sipërmarrjet tona .

Po perballemi me një sfidë për të gjitha sipërmarrjet tona që operojnë në këtë hapsirë të përbashkët, në një kohë kur synojmë një treg gjithnjë e më të integruar, diferencat në çmimet e karburanteve dhe në barrën fiskale krijojnë shtrembërime të konkurrencës, bizneset përballen me kushte të pabarabarta operimi dhe rritet rreziku i zhvendosjes së aktivitetit ekonomik drejt vendeve me kosto më të ulët.

Në një ekonomi të hapur dhe me varësi të lartë nga importet, për sipërmarrjen, kjo krizë po reflektohet në rritjen e kostove të energjisë, transportit dhe produkteve bazë, duke krijuar një situatë të paqëndrueshme dhe të vështirë për bizneset dhe konsumatorët.

Kjo nënkupton nevojën konkrete për harmonizimin e politikave fiskale, koordinimin e mekanizmave të furnizimit dhe zhvillimin e një qasjeje të përbashkët për përballimin e krizave energjetike në nivel rajonal.

Pa ndërhyrje të menjëhershme, ekonomite tona rrezikojnë gjithashtu një përshkallëzim të mëtejshëm të inflacionit dhe humbje të pozicionit konkurrues.

Në këtë kontekst, ne përfaqësuesit e organizatave të biznesit, që jemi nënshkruar të kësaj deklarate, theksojmë nevojën për një qasje të përbashkët rajonale në përballimin e krizave energjetike, përmes koordinimit të politikave fiskale dhe energjetike, shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimit të iniciativave të përbashkëta që rrisin sigurinë dhe stabilitetin ekonomik në rajon, duke kërkuar sa më poshtë vijon:

1. Rishikimi i barrës fiskale

Është e domosdoshme rishikimi i përkohshëm dhe fleksibël i barrës fiskale mbi karburantet. Struktura aktuale e çmimit përfshin një peshë të konsiderueshme taksash, e cila rëndon mbi biznesin dhe konsumatorin. Një ndërhyrje e targetuar do të ndihmonte në stabilizimin e tregut.

Masa të tilla duhet të jenë në linjë me praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat në periudha krize kanë aplikuar politika fiskale lehtësuese për të zbutur ndikimin mbi ekonominë dhe qytetarët.

2. Transparenca në përcaktimin e çmimit

Mungesa e transparencës në përcaktimin e çmimeve nga strukturat përkatëse mbetet shqetësuese. Kërkojmë publikim të rregullt të strukturës së çmimit; sqarim të faktorëve ndikues (tregjet ndërkombëtare, taksat, marzhet). Transparenca është thelbësore për rikthimin e besimit.

3. Forcimi i kontrollit të tregut

Institucionet duhet të garantojnë konkurrencë të ndershme përmes: monitorimit aktiv të operatorëve; hetimit të çdo rasti të mundshëm abuzimi apo marrëveshjeje të fshehtë si dhe luftës kundër informalitetit.

4. Mbështetje për sektorët më të ekspozuar

Sektorët si: transporti, bujqësia dhe agropërpunimi, industria prodhuese dhe fasoneria

shërbimet dhe turizmi janë ndër më të goditurit dhe kërkojnë mbështetje konkrete. Instrumentet lehtësuese janë të domosdoshme për të ruajtur konkurrueshmërinë dhe për të shmangur transferimin e plotë të kostove te konsumatori.

5. Masa afatmesme dhe afatgjata

- Krijimi i rezervave strategjike të naftës për të garantuar sigurinë energjetike në raste krize;
- Diversifikimi i burimeve të energjisë dhe reduktimi i varësisë nga importet;
- Investime në energji alternative dhe rritje të efikasitetit energjetik;

6. **Duhet të zhvillohet dialog i hapur**, i rregullt dhe zhvillimor mes qeverive dhe biznesit, në mënyrë që masat kundër krizës energjetike të jenë reale, të zbatueshme dhe në funksion të ruajtjes së vendeve të punës, prodhimit dhe investimeve duke garantuar stabilitetin ekonomik dhe social ne hapsirën mbareshqiptare.

Përfaqësuesit e organizatave të biznesit:

Forumit Ekonomik Mbarëshqiptar	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë	Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
Shoqata e Industrisë së Përpunimit të Qumështit	Shoqata e Bimëve Medicinale	PRO-Eksport Albania
Shoqata e Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare	Shoqata e Ndërtuesve	Shoqata e industrisë Ushqimore Shqiptare
Shoqata Shqiptare e Turizmit	Shoqata e Transportit Publik	Aleanca Kosovare e Bizneseve